



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-8864/26
Kaçanik, 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), të neni 6.2 (f) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 104/02-8864/26 nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës prej datës 16.04.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 prill 2026, mori këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE
KADASTRALE NË ZK KAÇANIK I VJETËR, NË EMËR
TË PERSONIT JURIDIK "KIVO" L.L.C

1. Me këtë Vendim, **SHPALLET** me interes publik prona e paluajtshme e parcelave kadastrale në **ZK Kaçanik i Vjetër**, me pronësi të personit Juridik "KIVO" L.L.C.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, shpallet me interes publik parcela e pronës, si vijon:
2.1 Parcela Kadastrale P-70917086-02301-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 44391 m^2$, në pronësi të personit Juridik "KIVO" L.L.C me numër personal 71050378, me vendndodhje në f. Kaçanik i Vjetër në ZK Kaçanik i Vjetër (shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria në pjesën e parcelës me sipërfaqe $1273 m^2$, e cila nevojitet për krijimin e një rruge të re).
3. **Shpallja** e interesit publik të pronës së përcaktuar si në këtë vendim, bëhet me qëllim që kjo pronë të kalojnë në pronësi të komunës së Kaçanikut, pas një procedure të shpronësimit, për realizimin e interesit publik- krijimin e një rruge të re.
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit. Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Serajdin Troni